



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7901 prot.

Himarë, më 21 . 10 . 2025

VENDIM

Nr. 48, Datë 17/10/2025

PËR

**“DHËNIEN E SHPËRBLIMIT TË PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË
OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025”**

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, të ndryshuar, VKM 503, datë 1.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-në nr. 483, datë 02.09.2025 “Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 17.10.2025, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga administrata e miratoi me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 2 (dy) abstenim dhe si më poshtë

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave për dhënie shpërblimi për personelin e MZSH të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 në vlerën 3,544,800 lekë.
2. Shpërndarjen e kësaj shume sipas listës emërore të personelit me detyrë në operacionet e shuarjes së zjarrit.

3. Ndarkohet Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak sipas listës emërore të personelit me detyrë në operacionet e shuarjes së zjarrit.
4. Efektet financiare të këtij vendimi të mbulohen nga fondi I emergjencave, miratuar me vendim të këshillit Bashkiak Himarë.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. 3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

